REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr 6834 Prot

Lushnje, më 08/08/2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
Këtu

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR BASHKIA LUSHNJE "

Plani i Arsimit Parauniversitar i Bashkisë Lushnje 2026–2028 është një dokument strategjik që synon përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në arsimin parauniversitar në nivel vendor. Ai nis me një analizë të kontekstit administrativ, demografik dhe ligjor, duke vendosur bazat për vendimmarrje të informuar.
Një pjesë e rëndësishme i kushtohet vlerësimit të shërbimit të arsimit parashkollor për vitin shkollor 2024–2025, përfshirë mbulimin me kopshte dhe kualifikimin e stafit edukativ.
Vëmendje i është kushtuar gjithashtu fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe aksesit fizik në infrastrukturë. Raporti trajton përfshirjen e grupeve vulnerabël dhe nevojat për përmirësim të kushteve higjieno-sanitare dhe materialeve didaktike.
Një tjetër kapitull analizon ndjekjen e shkollës fillore, 9-vjeçare dhe të mesme, duke nxjerrë në pah sfidat dhe arritjet për çdo nivel. Plani jep të dhëna specifike për çdo njësi administrative në Lushnjë, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem,Dushk,Kolonjë,Bubullimë,Fiershegan,Karbunarë,Ballagat.
Theksi vendoset në përhapjen dhe barazinë në ofrimin e shërbimit arsimor në të gjithë territorin. Për herë të parë, plani përfshin një vizion të qartë dhe objektiva strategjikë për vitet 2026–2028. Ai përmbledh investimet kapitale që do të realizohen, bazuar në prioritetet e identifikuara. Buxheti është planifikuar sipas të ardhurave vendore dhe mbështetjes nga qeveria qendrore.
Një seksion i posaçëm trajton planin e veprimit me matrica konkrete të aktiviteteve për çdo vit.

Qëllimi i planit është të përmirësojë cilësinë e arsimit parauniversitar në Bashkinë Lushnje, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve e shkollave, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të

arsimit universitar. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin.

Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij.

Monitorimi dhe vlerësimi janë të integruara për të garantuar transparencë dhe ndikim real në komunitet. Dokumenti përmbyllet me një analizë të kuadrit ligjor dhe procesit të rishikimit të planit sipas nevojës.

Ky plan i cili përbën një hap të rëndësishëm drejt një arsimi më gjithëpërfshirës, cilësor dhe të barabartë për të gjithë fëmijët e Bashkisë Lushnje,*ka kaluar në Konsultim publik në ambientet e Muzeut Historik Lushnje në datën 01.08.2025 me proces-verbal nr.6609 prot. datë 01.08.2025.*

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr6834/1 Prot

Lushnje, më08/08/2025

PROJEKT – VENDIM

Nr.73 Datë08/08/2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR BASHKIA LUSHNJE "

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, pika 1, neni 23 pika 12,neni 54,shkronja "k", ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar,kreu III, Nivelet e Arsimit Parauniversitar,neni 28 kreu IV, propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak Lushnje, "Plani i Arsimit Parauniversitar Bashkia Lushnje".

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e dokumentit "Plani i Arsimit Parauniversitar Bashkia Lushnje",sipas kërkesave të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohe Qendra e Arsimit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky Vendimin hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Qendra e Arsimit
Muarrem Sharka

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E mail:bashkia_lushnje@yahoo.com